



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. 184 Prot.

Tiranë më 28/5 /2015

**Proces-verbal**

**Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së**

Sot, në datën 28.5.2015 në orën 17:00, në ambientet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ( AMSHC ) u mbajt mbledhja e radhës e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së. Rendi i ditës, sipas njoftimit paraprak të Kryetarit të Bordit parashikonte:

1. Përcaktimi i fushave Prioritare për Thirrjen e radhës.
2. Shpallja e Thirrjes Nr. 8
3. Përcaktimi i bashkëfinancimit si prioritet i Thirrjes Nr. 8.
4. Të tjera

Verifikohet prania e Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së z. Andi Kananaj, si edhe e anëtarëve të Bordit si më poshtë :

1. Z. Adrian THANO
2. Z. Alban DUDUSHI
3. Z. Aldo MERKOCI
4. Znj. Gelardina PRODANI
5. Z. Ismail ADEMI

Kryetari i BM, z. Adrian Thano, pasi verifikon se është plotësuar kuorimi i nevojshëm, deklaronte hapur mbledhjen rreth orës 17:00.

Menjëherë Kryetari i jep fjalën Drejtorit Ekzekutiv z. Andi Kananaj i cili, pasi uron mirëserdhjen në AMSHC-së, propozon disa shtesa në rendin e ditës, si më poshtë:

1. Marrja në shqyrtim dhe miratimi i Rregulloren së ndryshuar të Amshc-së;
2. Marrja në shqyrtim dhe miratimi i strukturës së re organizative të Amshc-së.
3. Diskutimi dhe miratimi për mundësinë e koordinimit të punës mes AMSHC-së dhe organizatave rinore.

Përsa i përket propozimit të Drejtorit Ekzekutiv rreth pikave të rendit të ditës Kryetari i Bordit Mbikqyrës të AMSHC u shpreh: *'Duke qënë se kemi marrë edhe njoftim paraprak nga ana e Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së lidhur me propozimet për shtesat në rendin e ditës në këtë mbledhje, shpreh dakordësinë time për t'i pranuar si pika shtesë në rendin e ditës dhe për t'i marrë në shqyrtim gjatë kësaj mbledhje.'*

Më tej, mbledhja vijoi me diskutime rreth përcaktimit të fushave prioritare dhe më pas me diskutimin lidhur me shpalljen e Thirrjes Nr. 8.

Kryetari i Bordit z. Adrian Thano u shpreh: *"Mw lejoni qw të shpreh dhe tw ritheksoj paraprakisht faktin se në këtë Thirrje duhet t'i jepet prioritet kofinancimit."*

Pas diskutimeve lidhur me përcaktimin e fushave prioritare si edhe duke u bazuar tek të gjitha sugjerimet e anëtarëve të pranishëm në këtë mbledhje, dhe duke pasur parasysh edhe prioritetet qeveritare, Kryetar i Bordit bëri një përmbledhje të këtyre pikave të cilat ishin si më poshtë vijon:

- *Nxitja e zhvillimit lokal dhe rajonal, përmes përmirësimit të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes, si dhe aktivizimit të aktorëve të zhvillimit dhe komunitetit;*
- *Nismat mjedisore për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm;*
- *Nxitja e zhvillimit komunitar, rritja e fuqizimit të vullnetarizmit si edhe bashkëpunimit lokal dhe rajonal, përmes promovimit të mundësive për të rinjtë, artit, kulturës, traditës etj.;*
- *Zhvillimi i shoqërisë civile, përmes përmirësimit të instrumentave institucional, mekanizmave dhe mundësive;*
- *Diaspora dhe emigracioni;*
- *Promovimi i nismave të qeverisjes së mirë, përfshirë këtu luftën ndaj korrupsionit, zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të qyterarëve në politikbërje.*

Më pas Kryetari i Bordit Mbikqyrës së AMSHC-së mori miratimin e të gjithë anëtarëve të pranishëm për fushat prioritare të përcaktuara si më lart, si edhe miratimin për shpalljen e Thirrjes Nr. 8 bazuar në prioritetet e mësipërme.

Gjithashtu, në praninë dhe dakordësinë e të gjithë anëtarëve të pranishëm, u vendos që mënyra e financimit për këtë thirrje (Thirrja Nr. 8), do të realizohet sipas skemës së ndarjes së fondit në vlerat 50 %, 40 % dhe 10 %.

Gjatë kësaj mbledhje pati një rëndësi të veçantë edhe diskutimi lidhur me përmirësimin e AMSHC-së, reformimin e rolit dhe funksionit të saj si edhe nismat e mundshme për të rritur mbështetjen dhe për të fuqizuar AMSHC-në.

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së mori fjalën duke shpjeguar lidhur me pikat e rendit të ditës të propozuara prej tij. Ai u shpreh lidhur me ndryshimet e nevojshme të Rregullores së Brendshme të AMSHC- së dhe ristrukturimin organizativ të saj duke sqaruar se: *“Lidhur me rregulloren, janë realizuar ndërhyrje të nevojshme mbi ndryshimet veçanërisht të neneve mbi masat disiplinore duke i përshtatur ato me Ligjin 152/ 2013 „Për Nëpunësin Civil“. Është realizuar ndërhyrje duke i dhënë fuqinë ligjore të nevojshme akteve të brendshme administrative të Drejtorit Ekzekutiv. Gjithashtu, është realizuar përmbushja estetike e saj përmes plotësimit të neneve të ndryshme të cilat narrativën e tyre e orientojnë nga Ligji për AMSHC- në dhe Statuti i saj.”*

Gjatë këtij shpjegimi, Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, shpërndau për anëtarët e Bordit një realcion sqarues mbi shtesat dhe ndryshimet në Rregulloren e Brendshme të AMSHC-së.

Anëtarët e Bordit të pranishëm në këtë mbledhje, pasi diskutuan rreth rëndësisë së ndryshimit konstruktiv të Rregullores si edhe nevojës për ndryshimin e strukturimit organizativ të AMSHC-së, shprehën dakordësinë e tyre lidhur me propozimet e Drejtorit Ekzekutiv për miratimin e Rregullores së Ndryshuar si edhe për ristrukturimin organizativ të AMSHC-së.

Më pas Drejtori Ekzekutiv bëri sqarime lidhur me pikën e tretë të sugjeruar prej tij në rendin e ditës e cila ishte miratimi i bashkëpunimit me organizatat rinore. Ai shpjegoi rëndësinë e ngritjes së urave të koordinimit të punës me organizatat rinore, si edhe përkrahjen që AMSHC-ja do t'iu ofrojë këtyre organizatave.

Duke qënë se anëtarët e Bordit Mbikqyrës pranuan rëndësinë e këtij koordinimi të punës së AMSHC-së me organizatat rinore, u shprehën pozitivisht duke miratuar këtë pikë të rendit të ditës.

Në përfundim të mbledhjes Kryetari i Bordit Mbikqyrës të AMSHC kujton edhe njëherë që fushat prioritare të miratuara për Thirrjen Nr. 8 janë:

1. *Nxitja e zhvillimit lokal dhe rajonal, përmes përmirësimit të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes, si dhe aktivizimit të aktorëve të zhvillimit dhe komunitetit;*
2. *Nismat mjedisore për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm;*
3. *Nxitja e zhvillimit komunitar, rritja e fuqizimit të vullnetarizmit si edhe bashkëpunimit lokal dhe rajonal, përmes promovimit të mundësive për të rinjtë, artit, kulturës, traditës etj.;*
4. *Zhvillimi i shoqërisë civile, përmes përmirësimit të instrumentave institucional, mekanizmave dhe mundësive;*
5. *Diaspora dhe emigracioni;*
6. *Promovimi i nismave të qeverisjes së mirë, përfshirë këtu luftën ndaj korrupsionit, zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të qyterarëve në politikbërje.*



Kryetari i Bordit z. Adrian Thano bëri edhe një përmbledhje të vendimeve të miratuara në këtë mbledhje të cilat ishin si më poshtë vijon:

1. Përcaktimi i fushave prioritare si edhe Shpallja e Thirrjes Nr. 8
2. Skema e financimit sipas ndarjes së fondit në 50 %, 40 % dhe 10 %;
3. Vendosja e bashkëfinancimit si prioritet.
4. Miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e Brendshme të AMSHC-së si edhe miratimi i strukturës organizative të AMSHC-së.
5. Miratimi i koordinimit të AMSHC-së me organizatat rinore.

Të gjithë anëtarët e pranishëm aprovuan dhe firmosën për vendimet e marra.

Mbledhja u mbyll në orën 18:00.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

**Adrian THANO**

Kryetar i Bordit Mbikqyrës

**Majlinda DHUKA**

Nënkryetare e Bordit Mbikqyrës

**Alban DUDUSHI**

Anëtar

**Albana Kociu**

Anëtare

**Aldo MERKOCI**

Anëtar

**Endri FUGA**

Anëtar

**Gelardina PRODANI**

Anëtare

**Ismail ADEMI**

Anëtar

**Kozara KATI**

Anëtare